

**AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR**  
**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT**

Per “KLODIODA”

Procedura e prokurimit: “Sherbim Konsulence”

Numri i referencës së procedurës/lotit: **REF-82946-08-14-2018.**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “**Studim projektim mbikalimi TEG**” me fondin limit **8.790.561 lekë** (pa përfshirë vlerën e TVSH-së (tete milion e shtateqind e nentëdhjetë mijë e peseqind e gjashtëdhjetë e nje) leke pa tvsh, Afati i zbatimit të kontratës 6 muaj

Publikime të mëparshme): Buletini i Njoftimeve 20.08.2018, [Nr.33]

\* \* \*

Lista e operatorëve ekonomikë të kualifikuar në përfundim të fazës së parë të procedurës së sipërcituar:

1. “A & E Engineering”

*NIPT K72113010E*

2. “KLODIODA”

*NIPT K51813002H*

\* \* \*

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në fazat e tjera të procedurës së sipërcituar këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. “A & E Engineering”

*NIPT K72113010E*

Vlera : **8 750 000** (tete milion e shtateqind e pesëdhjetë mijë)

2. “KLODIODA”

*NIPT K51813002H*

Vlera: **8 700 000** (tete milion e shtateqind mijë)

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhtëm:

## 1. “A &amp; E Engineering”

NIPT K72113010E

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Komisioni i Vleresimit të Ofertave bëri kontrollin për veprimet aritmetike të cilat për operatorin A & E Engineering në strukturën e propozimit teknik numri rendor 9.- Ing ndertimi për rrugë, veprimi aritmetik i bërë është gabim pasi sasi \* leke është 6 m/njeri \* 70000 leke m/njeri = 840 000 leke . Nga veprimet e kryera nga KVO del që 6 m/njeri \* 70000 leke m/njeri = 420 000 leke. Si rezultat i këtij gabimi shuma totale nuk është 8 750 000 leke por 8 330 000 lekë pra ka diferencë prej 420 000 leke, kjo shumë në vlerë absolute është më shumë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar, kështu që KVO vendos refuzimin e ofertës së paraqitur nga operatorit ekonomik ”A & E Engineering ”bazuar në VKM nr. 914 datë 29.12.2014 i ndryshuar... neni 66, pika 4 ku shprehimisht.... nëse ka një gabim në një shumë total, që korrespondon me mbledhjen ose zbritjen e nëntotaleve, atëherë do të mbizotërojë nëntotali dhe totali duhet të korrigjohet. Shumat e korrigjuara në këtë mënyrë janë të detyrueshme për ofertuesin. Nëse ofertuesi nuk i pranon ato, atëherë oferta e tij do të refuzohet. Ofertat me gabime aritmetike refuzohen, kur shumat absolute të të gjitha korrigjimeve janë më të larta ose më të ulëta se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar”

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin “KLODIODA” me numer NIPT K51813002H dhe adresë, Rruga e Barikadave, Nr.118, Kati 3, Zyra nr.2”, Tiranë , se oferta e paraqitur nga ana juaj dhe e vlerësuar me 94.664 pikë, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [Autoritetit Rrugor Shqiptar/ Sektori i Prokurimeve ] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) siç parashikohet në nenin 49 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 12.10.2018

Ankesa: Nuk ka

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë \_